

VENDIM
Nr. 47, datë 5.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.10.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (K) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Klaudio Perçuke, Kejvin Zogo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1144 (240), datë 27.9.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës (*shërbimi i provës*), e cila nuk ka mbajtur qëndrim për kërkesën, por ka sjellë informacion për ecurinë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhënë ndaj kërkuësit Klaudio Perçuke, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësit janë arrestuar në flagrancë në datën 17.4.2016, pasi gjatë kontrollit në bagazhin e një automjeti të drejtuar nga kërkuësi Klaudio Perçuke, me të cilin ata po udhëtonin në drejtim të qytetit të Vlorës, brenda një qeseje plastike, është gjetur dhe sekuestruar lëndë narkotike e llojit *cannabis sativa*, në sasinë 1,60 kilogram. Ata janë proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë si autorë të veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i Kodit Penal (KP). Në kuadër të këtij procedimi penal ndaj kërkuësve është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”. Në përfundim të hetimeve paraprake, kërkuësit janë dërguar për gjykim me akuzën për kryerjen e veprës penale të përmendur më lart. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka proceduar me gjykim të shkurtuar, me vendimin nr. 178, datë 20.3.2017, ka vendosur t’i deklarojë ata fajtorë për veprën penale që akuzoheshin, duke dënuar secilin prej tyre me 7 vjet burgim dhe, në aplikim të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka urdhëruar zbritjen e 1/3-ës së dënimit. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuësit.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 424, datë 14.6.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të kryer nga kërkuesit, si dhe sa i përket dënimit të tyre. Konkretisht, gjykata e apelit ka vendosur: i. deklarinim fajtor të kërkuesit Klaudio Perçuke për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 281, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, uljen me 1/3-ën të këtij dënimi, duke e dënuar përfundimisht atë me 3 vjet e 4 muaj burgim, dënim për pjesën e pavuajtur të të cilit, bazuar në nenin 59 të KP-së, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit dhe vënien e tij në shërbim prove për një periudhë prej 3 vjetësh; ii. deklarinim fajtor të kërkuesit Kejvin Zogo për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 29 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, uljen me 1/3 e këtij dënimi, duke e dënuar përfundimisht atë me 19 muaj e 10 ditë burgim. Gjykata e apelit ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të dy kërkuesve, në rrethanat kur për kërkuesin Klaudio Perçuke urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur, ndërsa për kërkuesin Kejvin Zogo konstatoi vuajtjen tërësisht të dënimit të caktuar ndaj tij prej 19 muajsh e 10 ditësh burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë (*Prokuroria e Apelit Vlorë*), duke kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pretendimin se gjykata e apelit ka vepruar në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural penal.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1144 (240), datë 27.9.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë ka gjetur të drejtë cilësimin juridik që gjykata e shkallës së parë i ka bërë veprës penale të kryer nga kërkuesit, duke vlerësuar në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural penal cilësimin juridik të bërë nga gjykata e apelit, për rrjedhojë, edhe dënimet e caktuara prej saj ndaj kërkuesve. Në bazë të këtij vendimi të Gjykatës së Lartë mbi kërkuesit është vendosur detyrimi i vuajtjes së dënimit me burgim të caktuar për ata nga gjykata e shkallës së parë.

4. Kundër vendimit të Kolegjit Penal kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 10.1.2023 me ankime kushtetuese individuale të veçanta, duke kërkuar shfuqizimin e tij. Në datën 28.2.2023, për ankimin e kërkuesit Klaudio Perçuke, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërkohë, në lidhje me ankimin e kërkuesit Kejvin Zogo, Kolegji tjetër i Gjykatës në datën 13.3.2023 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 5.4.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe bashkimin e saj me çështjen e kërkuesit Klaudio Perçuke në një të vetme.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, pretendojnë se janë cenuar:

5.1. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në mënyrë indirekte, ka dalë jashtë juridiksionit të tij, për shkak se ka bërë vlerësimin e provave të vlerësuar më parë nga gjykatat më të ulëta. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar si gjykatë fakti, duke bërë krahasimin e veprimeve të kërkuesve, duke dalë në konkluzionin se ata duhet të dënohen për veprën penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së (Prodhimi dhe shitja e narkotikëve e kryer në bashkëpunim). Nga të gjitha provat e administruara në gjykim në gjykatat më të ulëta, nuk rezulton se kërkuesit të kenë kryer ndonjë veprim apo mosveprim që ka lidhje shkakësore me ardhjen e pasojës, mbajtjen e lëndës narkotike.

5.2. *Parimi i mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale (ne bis in idem)*, pasi sipas vendimit të dhënë nga gjykata e apelit, kërkuesi Klaudio Perçuke e ka shlyer dënimin e dhënë ndaj tij me shërbim prove. Ndërsa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka vendosur që ai të kryejë dënimin dy herë për të njëjtin fakt penal, duke urdhëruar vuajtjen edhe njëherë të dënimit për të.

5.3. *E drejta e gjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e kërkuesve është gjykuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pas pesë vjetësh nga regjistrimi i saj.

6. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmblledhur, ka prapësuar si vijon:

6.1. Pretendimi i kërkuësve për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në funksion të analizës së zbatimit të rregullt të ligjit, ka vlerësuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke i gjykuar brenda shkaqeve të ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka shqyrtuar zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta në raport me faktet dhe rrethanat e paraqitura prej tyre.

6.2. Pretendimi i kërkuësit Klaudio Perçuke për cenimin e *parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale* është i pabazuar, pasi ky parim është i lidhur ngushtë me pasjen e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, në formën e *gjësë së gjykuar*. Në këtë rast bëhet një përjashtim vetëm kur ndodh rigjykimi i çështjes. Vendimi i gjykatës së apelit që zgjidh në themel çështjen është vendim i formës së prerë, i cili e bën atë të ekzekutueshëm, por nuk është një vendim përfundimtar që plotëson kushtet për t'u quajtur gjë e gjykuar. Neni 462 i KPP-së dhe vendimi nr. 2, datë 3.11.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë e bëjnë të qartë natyrën e vendimit të gjykatës së apelit. Thelbi i një vendimi përfundimtar që kërkon instituti i gjësë së gjykuar është mospasja e mjeteve të ankimit për rishikimin ligjor të atij vendimi. Në këtë kuptim, vendimi i gjykatës së apelit nuk e plotëson kërkesën e këtij instituti. Nëse vendimi i gjykatës së apelit është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, do të thotë se disponimet e bëra prej saj janë të pavlefshme.

6.3. Kërkuësve nuk u është cenuar *e drejta e gjykimin brenda një afati të arsyeshëm*, pasi vonesat në gjykim kanë ardhur si rezultat i pamundësive objektive për procedim, të shkaktuara nga mospasja e përkohshme e kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përballimin brenda limiteve të arsyeshme të stokut të çështjeve të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë.

7. Subjekti i interesuar, shërbimi i provës, nuk ka paraqitur asnjë argument në kundërshtim të pretendimeve të kërkuësit Klaudio Perçuke.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Gjykata çmon se kërkuësit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës kërkon që individit t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit të kërkuar për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh, pas hyrjes në fuqi të instrumentit mbi konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1 - 399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata konstaton se këtë pretendim kërkuar e kanë parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Ata nuk rezultojnë të kenë bërë asnjë përpjekje dhe nuk kanë përdorur asnjë nga instrumentet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshejtimin e procedurave (neni 399/5 i KPC-së). Për rrjedhojë, për këtë pretendim Gjykata çmon se kërkuar nuk kanë shteruar mjetet në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës.

13. Për sa i përket pretendimit që ka të bëjë me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i ngritur prej të dy kërkuarve, si dhe pretendimit të kërkuarit Klaudio Perçuke për parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale, Gjykata konstaton se ato janë të lidhura me vendimin e Kolegjit Penal. Për rrjedhojë, në lidhje me to, Gjykata vlerëson se kërkuarit i kanë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendojnë se iu janë shkelur.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal mban datën 27.9.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.1.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj është pretenduar nga të dy kërkuarit, ndërsa cenimi i parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është pretenduar vetëm nga kërkuari Klaudio Perçuke. Në këtë kuptim, parimi i gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj do të shqyrtohet për të dy kërkuarit, ndërsa parimi i mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) do të shqyrtohet vetëm për kërkuarin Klaudio Perçuke. Gjykata, duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret dhe argumentet e paraqitura në kërkesë, çmon se nuk është vendi/nuk ka ndonjë shkak që ky pretendim të shqyrtohet në këndvështrimin e lirisë personale.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

16. Kërkuarit kanë pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në mënyrë indirekte, ka dalë jashtë juridiksionit të tij, për shkak se ka bërë vlerësimin e provave të vlerësuara më parë nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë ka arsyetuar si gjykatë fakti, duke bërë krahasimin e veprimeve të të pandehurve.

17. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në funksion të analizës së zbatimit të rregullt të ligjit, ka vlerësuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke i gjykuar brenda shkaqeve të ngritura në rekurs. Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka shqyrtuar zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta në raport me faktet dhe rrethanat e paraqitura prej tyre.

18. Shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj" është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, për të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (shih vendimet nr. 37, datë 25.4.2017; nr. 83, datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

19. Gjykata konstaton se pretendimin për cenimin e këtij parimi kërkuesit e lidhin me arsyetimin e Kolegjit Penal të Gjykatës të Lartë për gjurmët e gishtërinjve të kërkuesit Kejvin Zogo, të gjetura në qesen me të cilën ishte mbështjellë lënda narkotike. Në këtë kuptim, në vijim, Gjykata do të analizojë arsyetimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me këtë provë, për të vlerësuar nëse ky i fundit nëpërmjet këtij arsyeimi ka dalë jashtë juridiksionit të tij.

20. Në rastit konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë vlerësimin e saj për cilësimin juridik të veprës penale të kryer nga kërkuesit dhe dënimin e tyre, përveç provave të tjera dhe deklarimeve të kërkuesve, e ka bazuar edhe në aktin e ekspertimit daktiloskopik nr. 3935, datë 4.5.2016, për gjurmët e gishtërinjve të kërkuesit Kejvin Zogo të fiksuar në provën materiale, qesen plastike brenda së cilës është gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike. Ajo, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në lidhje me institutin e së drejtës penale të bashkëpunimit, ka arritur në përfundimin se kërkuesit, në marrëveshje midis tyre, kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar. Ndërkohë, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit, bazuar mbi të njëjtat rrethana të faktit dhe prova, përfshirë edhe aktin e ekspertimit daktiloskopik nr. 3935, datë 4.5.2016, për gjurmët e gishtërinjve të kërkuesit Kejvin Zogo, dhe në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale të kryer nga kërkuesit, duke caktuar për ata një dënim më të butë. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në rrethanat e faktit të pranuar nga gjykatat më të ulëta, ka gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me ekzistencën e bashkëpunimit mes kërkuesve në kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, rrethanë cilësuese kjo sipas ligjit dhe përcaktuese në cilësimin juridik të veprës penale dhe, për pasojë, në zbatimin e ligjit penal për sa i përket dënit për këtë veprë. Sipas Kolegjit Penal, duke e vënë interpretimin e ligjit mbi bashkëpunimin në kryerjen e një veprë penale sipas kësaj praktike gjyqësore (vendimit unifikues nr. 4/2011), në kontekst të analizës që kanë bërë dy gjykatat e faktit, argumentimi i vendimit nga gjykata e apelit në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale për të cilën është akuzuar kërkuesi Kejvin Zogo, e argumenti se ai nuk e ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i KP-së, por veprën penale të parashikuar nga neni 300/1 i KP-së, nuk është i drejtë. Në vlerësim të nenit 152 të KPP-së dhe anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 të KP-së, gjetja e gjurmëve të gishtërinjve në *corpus delicti*, qesen që përmbante lëndë narkotike, duhet të interpretohet nga gjykata në raport objektiv me provat e tjera, duke dalë në konkluzionin se ajo provon elementet objektive të veprimit të bashkëpunëtorit në kryerjen e veprës penale. Kjo në përputhje me interpretimin gjyqësor që i ka bërë rrethanës së bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë. Ndaj, sipas Kolegjit Penal nuk mund të jemi para veprës penale “Moskallëzimi i krimit” kur rezultojnë elemente të bashkëveprimit objektiv të autorit në arritjen e pasojës, që në këtë rast ka qenë sigurimi dhe posedimi i sendit të kundërligjshëm. Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e apelit, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e drejtë se rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, të pranuar si të tilla nga të dyja gjykatat e faktit, provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se dy kërkuesit, në marrëveshje midis tyre, në rolin e bashkekzekutorëve, me veprime aktive të kundërligjshme, të cilat nga ana objektive kanë konsistuar në mbajtjen me qëllim shpërndarjen e lëndës narkotike, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i KP-së, për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar. Në përfundim, me këtë arsyetim, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, Kolegji Penal ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

21. Për sa më sipër, Gjykata çmon të nevojshme të ritheksojë edhe njëherë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e saj se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar asnjë provë të re dhe nuk u ka dhënë vlerë të ndryshme provave të administruara nga gjykatat më të ulëta, si dhe nuk ka përcaktuar fakte të ndryshme nga ato që kanë përcaktuar këto të fundit. Gjykata e Lartë, e ndodhur në situatën kur dy gjykatat më të ulëta kishin zbatuar në mënyra të ndryshme ligjin material në zgjidhjen e çështjes, ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji, duke iu referuar vlerësimit që gjykata e shkallës së parë u ka bërë provave, si dhe fakteve të përcaktuara prej saj. Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj kushtetues, ka zgjidhur çështjen duke interpretuar ligjin

material – konkretisht KP-në, në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, rrethanën e bashkëpunimit dhe kriteret e alternativës së pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, duke iu referuar për këtë qëllim edhe vendimeve unifikuese. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka ndjekur procedurën ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik, duke ushtruar funksionet e saj në përputhje me atë natyrë gjykimi.

23. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale

24. Kërkuar Kludio Perçuke ka pretenduar se sipas vendimit të dhënë nga gjykata e apelit ai e ka shlyer dënimin me shërbim prove. Sipas tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka vendosur që ai të kryejë dënimin dy herë për të njëjtin fakt penal, duke urdhëruar vuajtjen edhe njëherë të dënimit për të.

25. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim i kërkuar Kludio Perçuke është i pabazuar, pasi parimi i mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale është i lidhur ngushtë me pasjen e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, në formën e *gjësë së gjykuar*. Në këtë rast bëhet një përjashtim vetëm kur ndodh rigjykimi i çështjes. Sipas këtij subjekti, vendimi i gjykatës së apelit, që zgjidh në themel çështjen, është vendim i formës së prerë, i cili e bën atë të ekzekutueshëm, por nuk është një vendim përfundimtar që plotëson kushtet për t'u quajtur gjë e gjykuar. Neni 462 i KPP-së dhe vendimi nr. 2, datë 3.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë e bëjnë të qartë natyrën e vendimit të gjykatës së apelit. Thelbi i një vendimi përfundimtar që kërkon instituti i gjësë së gjykuar është mospasja e mjeteve të ankimit për rishikimin ligjor të atij vendimi. Në këtë kuptim, vendimi i gjykatës së apelit nuk e plotëson kërkesën e këtij instituti. Nëse vendimi i gjykatës së apelit është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, do të thotë se disponimet e bëra prej saj janë të pavlefshme.

26. Gjykata ka vlerësuar se *ratio* i nenit 34 të Kushtetutës është sanksionimi i parimit “*të mos gjykimin dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale*” (*ne bis in idem*) dhe parimit të “*gjësë së gjykuar*” (*res judicata*). Këto dy parime vijnë si garanci të konfirmuara nga kjo dispozitë kushtetuese, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të individit në fushën penale (*shih vendimin nr. 1 datë 26.1.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këtë drejtim, parimi i mosgjykimin dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimin përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “*e njëjta vepër*” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepre penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 33, datë 22.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në çështjen në shqyrtim, nga aktet e administruara për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkuar Kludio Perçuke është akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhiimi dhe shitja e narkotikëve*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP-së. Për këtë vepër penale, fillimisht, ai është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë, duke u dënuar me 7 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, i është zbritur dënimin me 1/3-ën, duke u dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim. Më pas, mbi bazën e ankimit të tij, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës “*Prodhiimi dhe shitja e narkotikëve*”, tashmë sipas paragrafit të parë të nenit 281 të KP-së, dhe dënuar me 5 vjet burgim, si dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të KPP-së i ka zbritur dënimin me 1/3-ën, duke e dënuar përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim, dënim për pjesën e pavuajtur të të cilit, bazuar në nenin 59 të KP-së, ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit dhe vënien e kërkuar në provë për një periudhë prej 3 vjetësh. Ndërkohë, në vijim të këtij procesi gjyqësor, mbi rekursin e Prokurorisë së Apelit Vlorë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kontrolli kushtetues, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në

fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rikthyer kështu për të dënimin me 4 vjet e 8 muaj burgim (*shih paragrafët 1-5 më sipër*).

29. Sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, datë 20.3.2017, të lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kërkuesi Klaudio Perçuke është dënuar përfundimisht për të vuajtur dënimin e tij me 4 vjet e 8 muaj burgim. Gjithashtu, rezulton se urdhri i ekzekutimit për dënimin e tij me shërbim prove, sipas vendimit të gjykatës së apelit, ka filluar të ekzekutohet në datën 30.6.2017 dhe ka pushuar së ekzekutuari në datën 25.6.2020, për shkak të ligjit nr. 5/2020, “Për dhënie amnistie”. Gjykata vëren se nga data kur ka filluar ekzekutimi i dënimit të kërkuesit me shërbim prove deri në datën e pushimit të tij ka kaluar një periudhë prej rreth 3 vjetësh.

30. Për sa më lart, Gjykata eidenton se ndaj kërkuesit Klaudio Perçuke është zhvilluar vetëm një proces penal për akuzën e ngritur nga prokuroria. Nuk rezulton që për të njëjtën sjellje dhe veprim ndaj tij të jetë zhvilluar një proces i dytë gjyqësor ose që ai të jetë gjykuar dhe dënuar më shumë se një herë për të njëjtin fakt penal. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është vënë në lëvizje rregullisht me rekurs brenda të njëjtut procedim penal dhe në përfundim të shqyrtimit të rekursit, ai ka disponuar për cilësimin juridik të veprës penale të kryer dhe alternativën e dënimit me burgim. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe pretendimi i kërkuesit Klaudio Perçuke për cenimin e parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale është i pabazuar.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesve, sipas arsytimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.10.2023.

Shpallur më 6.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim